



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:168064

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05658169

PPP.nr.182/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit T.K. Sh.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit L.Z. nga fsh, Komuna e Ferizajt, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET PJESËRISHT si i bazuar prapësimi i debitorit L.Z., i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.176/22, të datës 18.07.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat P.Xh. nga Gjilani, sa i përket kamatës së kërkuar nga kreditori prej 8% nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për lejimin e përmbartimit sa i përket kamatës prej 8%, të kërkuar nga kreditori nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim.

II.REFUZOHET prapësimi i debitorit L.Z., i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.176/22, të datës 18.07.2022, sa i përket shumës së borxhit prej 1,918.11 euro, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 40 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbartimit, dhe **MBETET në fuqi** urdhri për përmbartim 1,918.11 euro, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 40 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.176/22, të datës 18.07.2022, Përmbauesi privat P.Xh., e ka caktuar përmbauesimin e propozuar nga kreditori T.K. SH.A, kundër debitorit L.Z., për pagesën e borxhit në shumë prej 1,918.11 euro, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 40 euro, në bazë të aktgjykimit C.nr.588/04, të datës 08.12.2010, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, me kamatë prej 8%, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbauesimin, si dhe pagesën e shpenzimeve të përmbauesimit, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit dhe nga shuma e fituar nga shitja e sendeve të debitorit të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbauesimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbauesimin.

Kreditore në përgjigjen e ushtruar me shkrim në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbauesimin.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbauesimin dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se:

Prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbauesimin i lëshuar nga Përmbauesi privat P.Xh., me numër P.nr.176/22, i datës 18.07.2022, është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm sa i përket kërkesës së kreditorit për pagesën e shumës së borxhit prej 1,918.11 euro dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 40 euro, si dhe për shpenzimet e përmbauesimit, ndërsa nuk është i bazuar sa i përket kamatës së kërkuar nga kreditore prej 8% nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbauesimin.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se debitori pretendon se ka shkelje në nxjerrjen e urdhrin për përmbauesimin të cilat shkelje e dëmtojnë rëndë dinjitetin e tij, urdhri është nxjerrë në bazë të dokumentit përmbauesimor i cili është ndryshuar dhe ka pushuar të ketë efekt juridik, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse nga shkresat e lëndës konstatohet se Përmbauesi Privat P.Xh., urdhrin e atakuar me prapësim e ka nxjerrë në pajtim me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, gjegjësisht në bazë të aktgjykimit C.nr.588/04, të datës 08.12.2010, i cili konsiderohet dokument përmbauesimor, për arsye se aktgjykimi i cekur është i pajisur me klauzolën e përmbaueshmërisë për përmbaueshmëri dhe i përshtatshëm për përmbauesimin. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës gjykata konstaton se aktgjykimi i cekur më lart nuk është anuluar me aktgjykimin AC.nr.2086/2012, të datës 02.04.2013, të nxjerrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, por i njëjti është vërtetuar. Për më tepër, Gjykata

konstaton se aktgjykimi i cekur është i plotfuqishëm nga ata 02.04.2013 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.05.2013, dhe është në kopje të vërtetuar nga origjinali, që nënkupton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së. Po ashtu, Gjykata vlerëson se aktgjykimi i cekur është i përshtatshëm për përmbarrim respektivisht në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, sepse në aktgjykim siç shihet është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit, siç është afati prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu, pretendimi i debitorit në prapësim se është parashkruar kërkesa e kreditorit, Gjykata konsideron se edhe ky pretendim nuk qëndron dhe është i pabazuar sepse nga shkresat e lëndës gjegjësisht nga aktgjykimi C.nr.588/04, i datës 08.12.2010, i cili është i plotfuqishëm nga data 02.04.2013 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.05.2013, dhe nga data e dorëzimit të propozimit për përmbarrim nga kreditori, siç është data 18.07.2022, konstatohet se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit, dhe kreditori propozimin e tij për përmbarrim e ka ushtruar brenda periudhës kohore prej 10 viteve, si dhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 361, paragrafi 1, i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në të cilin është paraparë shprehimisht se: *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”*.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se propozimi për përmbarrim nuk është i plotë konform dispozitave ligjore, Gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse nga propozimi për përmbarrim i kreditorit, vërtetohet se kreditori propozimin e tij për përmbarrim e ka përpiluar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, sepse në propozimin për përmbarrim janë treguar kërkesa për përmbarrim, dokumenti përmbarrimor në kopje të vërtetuar, të dhënat e kreditorit dhe të debitorit, adresa e vendbanimit dhe e selisë së kreditorit dhe e debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.

Gjykata me rastin e pranimit të prapësimit të debitorit sa i përket kamatës prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbarim, të kërkuar nga kreditori dhe shfuqizimit të urdhrit për përmbarim për këtë kamatë, mori për bazë aktgjykimin C.nr.588/04, të datës 08.12.2010, në të cilin përveç detyrimit të debitorit që kreditorit t'ia paguaj shumën e borxhit prej 1,918.11 euro dhe shumën e shpenzimeve të procedurës kontestimore prej 40 euro, nuk është paraparë dhe nuk është vendosur edhe për kamatën prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbarim, siç e ka kërkuar kreditori me propozimin për përmbarim.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, përgjigjen me shkrim të kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, përkatësisht është i bazuar sa i përket kamatës së kërkuar nga kreditori prej 8% nga data e paraqitjes së propozimit për përmbarim dhe për këtë pjesë gjykata e pranoj prapësimin e debitorit dhe e shfuqizoj urdhrin për përmbarim P.nr.176/22, të datës 18.07.2022, ndërsa nuk është i bazuar prapësimi i debitorit sa i përket shumës së borxhit prej 1,918.11 euro dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 40 euros, si dhe për shpenzimet e procedurës së përmbarimit, dhe për këtë pjesë Gjykata e refuzoj prapësimin e debitorit dhe vendosi që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi për shumën e borxhit prej 1,918.11 euro dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 40 euro, si dhe për shpenzimet e përmbarimit.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.182/22, më datë 07.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranim